

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses Luljete Shabani, me sekretaren juridike Resmije Krasniqi, në lëndën penale kundër të pandehurve F.B dhe A. M, për shkak të veprës penale, **Sulmi, nga neni 187, par. 1**, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), sipas aktakuzës; PTH, me nr. PP.II. 1964/16, të dt. 28.10.2016 dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor së Prokurorisë Themelore në Gjilan, më datën 09.11.2016, mori këtë :

AKT GJYKIM

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurve :

1 F. B, nga babai Z, i lindur më ...në Gj, jeton në fsh. P, K. e Novobërdës, kamarier, i punësuar në kafiterinë "...” në Gj me gjendej të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës

2. A. M, nga babai I, i lindur më ...në K, jeton në Gji.lan,..”, nr. , i papunë, me gjendje të mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

JANË FAJTORË

Sepse,

I. I pandehuri më dt. 25.10.2016, rreth orës .. me dashje , pa pëlqimin e tij, e ka sulmuar të pandehurin tjetër Arton Marovca, në atë mënyrë që, derisa A, së bashku me shokun e tij, ...kanë shkuar në restorantin "...” për ta kërkuar pagesën për punën që E kishte bërë në këtë kafiteri dhe për një moment ka filluar mosmarrëveshja në mes të Artonit dhe të pandehurit tjetër F. B, pastaj, kanë filluar të të fyhen në mes vete, me ë’rast, i pandehuri Fadil, në shenjë revolte e ka goditur A në kokë me një shportë plastike, por, pastaj, kanë intervenuar disa persona hde i kanë ndarë,

- me çka ka kryer veprën penale, **Sulmi, nga neni 187, paragrafi 1**, të KPRK-së,

II. I pandehuri **A.M** në të njëjtën ditë, kohë dhe vend, si në dispozitivin e parë të kësaj katakuze, janë marrë vesh në mes vete dhe me dashje, e pa pëlqimin e tij, e ka sulmuar të pandehurin tjetër Fadil Behluli, në atë mënyrë që, pasi ishte sulmuar nga Fadili,, ka filluar të kacafytet me te dhe pastaj, me një kubëz betonie ka gjujytur ate, me ë’rast, kanë intervenuar pesonat e tjerë dhe i kanë ndarë ata,

-me çka, ka kryer veprën penale **Sulmi, nga neni 187, par.1**, Itë KPRK-së, andaj, në bazë të dispozitës së lartëcekur ligjore dhe neneve 3, 34, 35, 36, 39 dhe 64 të KPK, si dhe nenit 493 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurve u shqipton

DËNIM ME GJOBË

1. Ashtu që të pandehurit **F. B**, i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej **150 € (njëqindpesëdhjetë) €**, të cilin dënim i pandehuri do t’a paguaj në afat prej 2 (dy) muajve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.
2. Të pandehurit **A. M**, i caktohet dënimi me gjobë në shumë prej **150 € (njëqindpesëdhjetë) €**, të cilin dënim i pandehuri do t’a paguaj në afat prej 2 (dy) muajve, pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Nëse të pandehurit refuzojnë që ta paguajnë dënimin me gjobë, ose nuk janë në gjendje ta paguajnë atë, atëherë dënimi me gjobë me pajtimin e të pandehurit mund të zëvendësohet në punë në dobi të përgjithshme. Nëse të pandehurit nuk pajtohen me zëvendësimin e dënimit me gjobë në punë

në dobi të përgjithshme, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 € të dënimit me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

Obligohen të katër të pandehurit, secili veç e veç, t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej nga **20 €**, në emër të paushallit gjyqësor, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga data kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzën PP. II, Nr. 1964/2016, të datës 28.10.2016, ndaj të pandehurve..., për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 187, par.1 të KPRK. Gjithashtu, Prokuroria Themelore në Gjilan, ka paraqitur kërkesë për dhënjen e urdhërit ndëshkimor, sipas të cilit të pandehurve ka kërkuar që t'u shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ngase janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë.

Gjykatësja, pasi shikoi dhe analizoi aktakuzën, kërkesën për dhënjen e urdhërit ndëshkimor dhe gjitha shkresat e tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e Prokurorisë Themelore për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të pandehurvedhe të pandehurve u shqiptoi dënimin me gjobë, ngase të dhënat e paraqitura në aktakuzë dhe provat e bashkangjitura, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhërit ndëshkimor.

Në bazë të deklaratave së të pandehurve, deklaratave të deklaratave të dëshmitarëve të cilat janë në shkresat e lëndës, si dhe shkresave tjera të lëndës, gjykatësja konstatoi se të katër të pandehurit, e kanë kryer veprën penale që u vihet në barrë, Sulmi nga neni 187, paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u ceken më lartë, gjykata e ka pranuar kërkesën e PPK dhe ndaj të pandehurve, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor ka shqiptuar dënim me gjobë, ngase sipas bindjes së kësaj gjykate, dënimi me gjobë është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë së tyre, si dhe me caktimin e dënimit me gjobë do të mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 34 të KPK.

Vendimi për shpenzimet e procedurës penale, është marrë në bazë të nenit 495 paragrafi 1 lidhur me nenin 365 paragrafi 1 të KPP.

Nga të cekurat e më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN më 09.11.2016

**Sekretarja juridike,
Resmije Krasniqi**

**Gjykatësja,
Luljete Shabani**

KËSHILLA JURIDIKE : Kundër këtij aktgjykimi i pandehuri ose mbrojtësi i tij, mund të paraqesin kundërshtim në afat prej 8 (tetë) ditëve nga dita e pranimin të të njejtit. Të pandehurit njoftohen se pas kalimit të afatit për kundërshtim, kur kundërshtimi nuk paraqitet, urdhri ndëshkimor merr formë të prerë dhe do të ekzekutohet dënimi i shqiptuar me këtë aktgjykim.